



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Nr. 945 / 27 Prot.

Tiranë, më 31 / 12 /2017

V E N D I M

Nr. 217, Datë 31.12.2017

P Ë R

AUDITIMIN E USHTRUAR NË 8 SUBJEKTE PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E TREMUJORIT IV TË VITIT 2016, RESPEKTIVISHT BASHKITË: DIBËR, LIBRAZHD, DEVOLL, VORË, KËLCYRË, KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR, INSTITUCIONI I PREFEKTIT QARKUT KORÇË DHE NDËRMARRJA BALNEARE (LLIXHAT) PESHKOPI ”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në Tremujorin e IV të vitit 2016*”, të ushtruar në 8 Subjekte, respektivisht Bashkitë: **Dibër, Librazhd, Devoll, Vorë, Këlcyrë, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë dhe Ndërmarrja Balneare (Llixhat) Peshkopi**, sipas programit të auditimit nr. 945 prot, datë 07.09.2017, ndryshuar me shkresën nr. 945/13 datë 30.10.2017, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit .

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi i realizuar në 8 subjektet e verifikuara për zbatim e detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në Tremujorin e IV të vitit 2016 rezultoi një nivel i pranueshëm zbatueshmërie në masën 92%, nga **134 masa organizative** të rekomanduara janë

pranuar **123** masa dhe nuk janë pranuar 11 masa. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 54 masa, nuk janë zbatuar 30 masa, ndërsa 39 masa janë në proces zbatimi, pra në një total prej 93 masash organizative. Subjektet të cilat nuk kanë zbatuar masat organizative të rekomanduara nga KLSH përmendim: Bashkia Këlcyrë 18 masa, Dibër 6 masa organizative, Devoll 3 masa *(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet ne Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Vendimi)*

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Në 8 subjektet e audituara për zbatimin e *detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në Tremujorin e IV të vitit 2016*, konstatohet se nga vlera e rekomanduar për 106 masa shpërblim dëmi prej **213,878 mijë lekë**, janë pranuar dhe janë në proces zbatimi 103 masa në vlerën **210,347 mijë lekë**, nga e cila vlerën **137.758** mijë lekë duke qenë se janë hartuar paditë gjyqësore është konsideruar në proces ose në masën 98 % , duke mos u pranuar po pa mundësi arkëtimi 3 masa shpërblim dëmi në vlerën prej **13,537 mijë lekë**, nga e cila vlera prej 10,006 mijë lekë i përket mos fillimit të ndalesave për pagesat e ish këshilltarëve për mos pjesëmarrje në mbledhjet e ish këshillave respektivisht, Bashkia Librazhd në vlerën 8,698 mijë lekë dhe Bashkia Devoll në vlerën 1,398 mijë lekë.

-Nuk pranohet 3 masa shpërblim dëmi në vlerën **prej 3,531 mijë lekë respektivisht: -vlera prej 2,700 mijë lekë** i përket Bashkisë Dibër për mos kryerjen e ndalesave për qiratë e antenave të A..... dhe V....., pasi ka pretendime me marrjen e kësaj takse nga Ministria e Brendshme apo Bashkia, të cilat janë në proces gjyqësor.

-**vlera prej 635 mijë lekë** i përket Prefekturës Korçë, rekomandim i cili ka lidhje me dhënien e 100 litrave karburant në muaj për mjetet e veta të cilët i përdorin 2 Nënprefektëve të Bashkisë Devoll dhe Pogradec me urdhër të Prefektit, pasi Institucioni nuk u mundëson dhënien e mjeteve, pretendimi tyre është se mbështeten në nenin 127 të Kodit Punës, i cili e parashikon marrjen e mjeteve nga punonjësit kundrejt një marrëveshje, ndërkohë që Prefektura Korçë këtë aktmarrëveshje e kishte zëvendësuar me urdhrin e Prefektit dhe pas konstatimit nga KLSH është ndërprerë furnizimi me karburant.

- **Vlera prej 196 mijë lekë** i përket Këshillit të Qarkut Gjirokastrë për udhëtim e dieta për ditë të shtuna si ditë pushim me arsyetimin se mbledhjet e zhvilluara kanë koiciduar ditët e premte dhe për largësinë që ka Gjirokastrë me Tiranën punonjësit janë kthyer ditën e pushimit javor të shtunë.

Nga vlera e rekomandimeve për të 8 subjektet e audituara prej **213,878 mijë lekë**, deri më datën 17.11.2017 **gjendja paraqitet si më poshtë:**

-Për 6 subjekte në vlerën **16,527mijë lekë**, ose në masën 8% janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë për kryerjen e ndalesave dhe janë në proces zbatimi.

-Për 2 subjekte në vlerën **10,689** mijë lekë, janë në proces arkëtimi.

-Për 5 subjektet në **vlerën 137.758** mijë lekë ose në masën 65 % janë në proces gjyqësor civil apo penal, nga e cila vlera **136,518** mijë lekë është në proces civil, pra pas nxjerrjes së urdhrave të ekzekutimit, palët i janë drejtuar gjykatës dhe vlera 14,240 mijë lekë është në proces penal etj. *(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave për shpërblim dëmi paraqitet ne Aneksin nr. 2, bashkëlidhur këtij Vendimi)*

C.MASAT DISIPLINOR DHE ADMINISTRATIVE

Në 8 subjektet e verifikuara për zbatim të rekomandimeve nga KLSH janë rekomanduar fillimin e procedurave disiplinore për **153 masa** nga të cilat janë pranuar duke u shqyrtuar në komisionet disiplinore dhe prej tyre janë zbatuar **103 masa** ose në nivelin 67%, duke mos u

zbatuar 50 masa, prej tyre rreth 24 masa ose gjysmën e tyre i përket Bashkisë Këlcyrë pasi nga KLSH, APP-së i janë rekomanduar 28 masa për shkelje në procedurat e prokurimit për të cilat APP ka ndëshkuar me gjobë vetëm 9 persona, kurse 19 personat e tjerë nuk është mbajtur qëndrim dhe marrja e masave disiplinore ndaj tyre nuk mund të merret pasi pjesa më e madhe e tyre janë ish punonjës të ish komunave në cilësinë e anëtarëve të KVO dhe për arsye të reformës territoriale ata kanë prerë marrëdhëniet e punës, kështu edhe këto masa konsiderohen të ezauruara (*Në mënyrë të detajuar realizimi i masave disiplinore dhe administrative paraqitet ne Aneksin nr. 3, bashkëlidhur këtij Vendimi*)

Ndërsa realizimi i rekomandimeve për secilin nga 8 subjektet në mënyrë të detajuar paraqitet më poshtë:

1.BASHKIA DEVOLL

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH janë i rekomanduar Bashkisë Devoll 18 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 11 masa, janë në proces zbatimi 4 masa dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative. Prandaj KLSH rikërkon zbatimin e plotë edhe të 7 rekomandimeve për masa organizative si më poshtë:

1/3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim, Zhvillim Territorit, të marrë masa për hartimin dhe miratimin në Këshillin Bashkiak dhe më pas në KKT, Instrumentin e Përgjithshëm Ndërvendor dhe Planet e Detajuara Vendore, më pas të vijojnë procedurat për dhënien e lejeve të shfrytëzimit dhe përdorimit për objektet private ose publike.

Menjëherë

2/3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, të marrë masa për ngritjen e Këshillit Teknik me specialist të fushës dhe në asnjë rast lejet e zhvillimit të mos lëshohen pa u miratuar në Këshillin Teknik.

Menjëherë

3/8.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Devoll, të marrë masa për **nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore**, bazuar në pikën 3 të nenit 70, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për arkëtimin e vlerës **12,369,576 lekë, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

b. T’i kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit, vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar;

c. Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

Menjëherë

4/9.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor (IMTV), në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Devoll, të marrë masa për kontabilizimin e gjobave dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerës **3,600,000**

lekë, sipas pasqyrës Aneks 25, bashkëlidhur Raport Auditimit, si dhe të kërkojë në gjykatë rivendosjen në afat për vendimet me gjobë të vendosura gjatë viteve.

Menjëherë

5/15.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të evidentojë, saktësojë, llogarisë dhe arkëtojë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **1,628,443 lekë nga 26 subjekte të Bashkisë Devoll dhe ish Komunës Hoçisht** (sipas pasqyrës Aneks nr. 17 dhe 21, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), bazuar në nenin 70, të ligjit nr. nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Menjëherë

6/17.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara plotësisht ose pjesërisht, për 6 masa organizative me vlerë **13,457,000 lekë** dhe 7 masa shpërblim dëmi me vlerë **3,613,631 lekë, respektivisht:**

a-Në ish Bashkinë Bilisht, për 5 masa organizative me vlerë **13,457,000 lekë** dhe 4 masa shpërblim dëmi me vlerë.

b-Në ish Komunën Miras, për një masë organizative dhe një masë shpërblim dëmi me vlerë **2,350,466 lekë.**

c- Në ish Komunën Qendër Bilisht, për 2 masa shpërblim dëmi në vlerën **989,665 lekë**

Menjëherë

7/18.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masa për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për ngritjen e një sistemi të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e tij, për hartimin e një plan-veprimi konkret, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë identifikimin dhe menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik. Në fund të periudhës ushtrimore të bëhet vetëvlerësimi dhe të raportohet për funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej 56,698,201 lekë është pranuar dhe është kontabilizuar kjo vlerë, nga 28 rekomandime, 2 janë zbatuar, 26 janë në proces dhe gjendja deri më datën 17.11.2017 paraqitet si më poshtë:

Nga vlera prej.....	56,698,201 lekë
-Janë arkëtuar deri më dt.17.11.2017 30 raste.....	4,828,151 lekë
-Mbeten debitorë pa u arkëtuar më dt.17.11.2017.....	51,870,050 lekë
Nga e cila:	
Janë në proces gjyqësor 39 raste.....	48,844,426 lekë
Janë në proces arkëtimi vlera	170,265 lekë
Nisur njoftimet por nuk kanë filluar ndalesat	751,635 lekë
Në proces verifikimi pagesat e këshilltarëve.....	1,308,483 lekë
Tatimi i pa llogaritur për ish këshilltarët.....	795,241 lekë

Për realizimi e rekomandimeve rikërkojmë si më poshtë:

1/5.1. Rekomandimi: Duke qenë se për rekomandimin nr.5 për **Bashkinë Devoll** nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej **1,308,483 lekë** deri më datën 17.11.2017 edhe pse nga Bashkia është bërë njoftimi, nga ana e personave ende nuk është paguar detyrimi prej 1,308,483 lekë. Po kështu nuk është zbatuar edhe rekomandimi nr.6 për arkëtimin e vlerës **795,241 lekë** sa paguar ish këshilltarët dhe për mos pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit Bashkiak të ish

Komunës Progër për vlerën 208,436 lekë, Qendër Bilisht për vlerën 225,249 lekë, Hoçisht për vlerën 197,265 lekë dhe Miras për vlerën 164,291 lekë, sipas pasqyrës Aneks 1,2, 5, 5/1 dhe 7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në kushtet e pamundësisë nga KLSH të verifikimit rast pas rasti të dokumentacionit dhe protokolleve të mbledhjeve për pagesat e këshilltarëve të ish-Komunave dhe Bashkisë, mbështetur në shkronjat (i) dhe (f) të nenit 15, -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; sipas të cilit “KLSH ka të drejtë ti propozojë njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik të kryejnë auditime brenda kompetencës të tyre”; nenit 25-Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit, të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe ISSAI 1600, **rekomandojmë:**

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Tuaj, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të verifikojë të gjithë dokumentacionin mbi të cilin është bërë pagesa e këtyre këshilltarëve.

Pas verifikimit dhe saktësimit të këtyre pagesave, **i lihet në kompetencë Kryetarit të Bashkisë**, të përcaktojë masat përkatëse në lidhje me vlerën e dëmit që duhet të kthejnë në buxhet këshilltarët. Ndalesat që bëjnë fjalë për mos llogaritjen e tatimit mbi pagë duhet të paguhet, pasi janë në kundërshtim me kërkesat e kreut II-të, neni 8 “E ardhur e tatueshme” shkronja “g”, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar me ligjin nr. 83/2014 datë 17.07.2014 dhe 156/2014 datë 27.11.2014.

Menjëherë

2/24.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **127,894 lekë**, e cila përfaqëson kryerjen e shpenzimeve për telefonin celular, nga ish Kryetari i Komunës Progër **A. A.**

Në vazhdimësi

3/25.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **630,000 lekë nga Fondacionin “M... E...”**, përfituar mbi bazën një dokumentacioni financiar të pa plotë e të parregullt dhe jo ligjor.

Në vazhdimësi

4/27.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **17,263,893 lekë**, nga subjekti privat “**K... F... “B.... S....” shpk**, i cili ka përfituar me pa të drejtë këtë shumë sipas kontratave të paligjshme.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, **i rikërkohet Kryetarit të Bashkisë, dhe komisionit disiplinor fillimin e procedurës** për dhënien e masës disiplinore “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj “ për **D. K.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Arsim Kulturës, në cilësinë e ish Nënkyetarit.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Kryerjen e shpenzimeve për organizime e realizim aktiviteteve social-kulturore në shumën 768,700 lekë, në mungesë të dokumentacionit ligjor, në kundërshtim me VKM nr. 243 datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar, pika 26 e nenit 4, të nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe

kontrollin” dhe pikave 35 dhe 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D.1.Mbi gjobat e rekomanduara Agjencisë Prokurimit Publik.

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2016, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, KLSH me shkresën nr. 732/10 datë 19.12.2016 i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për **9 personat**.

Duke qenë se personat e dënuar me gjobë nga APP janë në proces ankimimi në gjykatë, KLSH kërkon ndjekjen e procedurave ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit deri në arkëtimin e plotë të vlerës gjobave të vendosura nga APP.

Menjëherë

2.BASHKIA DIBËR

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH-ja, janë rekomanduar për Bashkinë Dibër 19 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 8 masa dhe nuk janë zbatuar 6 masa organizative.

Gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar nga masat organizative vlera e taksave vendore për shumën 15,983,000 lekë nga e cila 347 biznese në vlerën prej 9,852,000 lekë dhe nga popullata janë paguar vlera 6,131,000 lekë nga 7,761 abonent familjarë për të cilat rikërkojmë të vazhdojnë procedurat ligjore, **si më poshtë:**

1/3.1-Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa për verifikimin në terren të statusit juridik të aseteve të qëndrueshme sipas listës të miratuar me *VKM nr.1533, datë 19.11.2008* dhe të veprohet sipas procedurave ligjore:

a. Në rastet kur asetet posedohen nga persona të tretë, të paautorizuar, të lajmërohen personat dhe të lidhen kontrata qiraje për trojet e lira, ndërtesat dhe trojet funksionale, duke kërkuar arkëtimin e të ardhurave të munguara në **shumën 480,076,800 lekë**.

b. Në rast se nuk arrihet marrëveshje me personat përkatës, të bëhet denoncim në organet kompetente të zbatimit të ligjit dhe të veprohet në bashkëpunim me strukturat e bashkisë, Policinë Bashkiake për lirim të aseteve të zëna forcërisht dhe të vihen këto në posedim të bashkisë si pasuri në shërbim të komunitetit.

Menjëherë

2/8.1-Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa që për mbledhjen e arkëtimin e taksave dhe tarifave nga popullata, të caktojë si agjent tatimor Ujësjiellësin sh.a Dibër dhe për realizimin e saj të përgatitet aktmarrëveshja e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak, si dhe të kryejë rakordimet periodike mujore/tremujore/vjetore.

Menjëherë

3.3.1-Rekomandimi: Nga Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Dibër, ndaj investitorit Shoqata “S...” për mos pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë të **nxirret njoftim vlerësimi tatimore** për vlerën **1,609,777 lekë**, bazuar në nenin 70, pika 3, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar,

a. T'i dërgohen Bankave urdhrat e duke ndjekur rrugët e mëposhtme: bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

b. T'i kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH " të ndryshuar.

c. Në se nuk paguan detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat tatimore në R.SH" të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë)

Menjëherë

4.6.1-Rekomandimi: Nga IMTV e Bashkisë Dibër, të merren masat e nevojshme dhe të organizohet puna me programe vjetore e mujore të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, për Kontrollin e Territorit në gjithë juridiksionin e vet, përfshi Njësitë Administrative, në zbatim të kërkesave ligjore.

Të procedohet sipas kërkesave ligjore, me prishjen e ndërtimeve pa leje të konstatuara dhe arkëtimin e vlerës së gjobës.

Të riorganizohet struktura e IMTV me personel të kualifikuar sipas kërkesave ligjore.

Menjëherë

5.17.1-Rekomandimi: Të merren masa që të riorganizohet struktura e Policisë Bashkiake, me personel të kualifikuar, të programohet dhe monitorohet aktiviteti i saj me programe dhe detyra të qarta të urdhëruara nga Titullari i Bashkisë. Të merren masa, e të pajisen punonjësve të policisë me uniformë sipas kërkesave ligjore

Menjëherë

6/18.1-Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të ri kërkua me shkresën nr. 950/7 prot., datë 18.12.2014, në zbatim të kërkesave ligjore. Të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit të pa arkëtuar në shumën **5,969,635 lekë** duke bërë kërkesë padi në Gjykatë ndaj subjekteve debitorë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera prej **80,722,616 lekë** e rekomanduar nga KLSH, nuk pranohet vlera prej **2,700,000 lekë**, pranohet vlera prej **78,022,616 lekë** të cilat janë kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 –debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2016 (bilanci vjetor 2016). Nga 14 masa për shpërblim dëmi janë pranuar të 14 masat të cilat janë në proces zbatimi apo proces gjyqësor.

Rekomanduar nga KLSH vlera.....80,722,616 lekë

Arkëtuar deri më datën 31.10.2017 vlera.....85,108 lekë

Janë sistemuar gabim vlera.....5,695,018 lekë

Gjithsejt.....5,780,126 lekë.

Mbeten..... 74,942,490 lekë

Nga e cila:

-Janë në proces gjyqësor vlera prej.....69,315,570 lekë

-Janë nisur njoftimet për vlerën2,926,800 lekë

-Nuk pranohen nga subjekti vlera.....2,700,000 lekë

për të cilat rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:

1/1.1-Rekomandimi: Të merren masat dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për shpërblimin e dëmit për vlerën **9,402,678 lekë**, nga 7 subjekte qiramarrës, respektivisht: H. S.” shpk **5,799,273 lekë**, F. M. për vlerën **220,800 lekë**, “subjekti “G.....” shpk për vlerën **682,605 lekë**, T.....” sha për vlerën **900,000 lekë**, “E.....” sha për vlerën **900,000 lekë** dhe “A.....” sha për vlerën **900,000 lekë**.

Në vijimësi

2/2.1-Rekomandimi: Të merren masat dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për shpërblimin e dëmit për vlerën **58,710,570 lekë** nga 38 subjekte të cilët kanë ndërtuar me leje ndërtimi, objekte mbi truallin publik dhe nuk kanë paguar vlerën e qerasë të truallit, sipas listës emërore të pasqyrës në fq. 137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2-Nga verifikimi rezultoi se:

Nga 38 subjekte të cilët kanë ndërtuar me leje ndërtimi, objekte mbi truallin publik dhe nuk kanë paguar vlerën e qerasë të truallit **nga vlera e rekomanduar prej 58,710,570 lekë deri më datën 31.10.2017** ishin mjaftuar vetëm me dërgimin e njoftimeve për shpërblim dëmi por asnjë person nuk ka paguar në mënyrë vullnetare.

Pas rikërkimit të audituesve të KLSH gjatë periudhës verifikimit të zbatimit rekomandimeve nga Bashkia Dibër janë hartuar paditë gjyqësore ndaj 38 personave në vlerën 58,710,570 lekë, për të cilën KLSH **kërkon ndjekjen e të gjithë** shkallëve të gjykimit.

Menjëherë

3/10.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **149,412 lekë** nga ish anëtarët e Këshillave dhe ish-Kryetarë të fshatrave të ish-Komunave Tomin me 34 raste për vlerën 78,662 lekë, Luzni me 16 raste për vlerën 26,880 lekë, Zall- Dardhë me 21 raste për vlerën 19,530 lekë dhe Sllövë me 23 raste për vlerën 24,340 lekë sipas pasqyrave në fq. 62, 63, 68, 70, 74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

4/12.1-Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **99,500 lekë**, nga anëtarët e komisionit të blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla; **D. K.** me detyrë ish Përgjegjëse e Financës Komuna Tomin, për vlerën **33,167 lekë**; **M. D.** ish-anëtare për vlerën **33,167 lekë**; **Q. T.** ish-anëtarë për vlerën **33,166 lekë**.

Menjëherë

5.8.1-Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masat, duke ngritur një komision me specialistë të fushës, të identifikojë personat përgjegjës debitorë për mungesën **e mjeteve të transportit** duke ndjekur inventarizimet në vite deri në origjinën e krijimit të asetit.

Në mungesë të dokumentacionit kontabël ligjor, të merren masat dhe të kërkohet sipas procedurave ligjore, **arkëtimi i vlerës 726,800 lekë nga:**

- B. H. me detyrë ish Kryetari i Komunës Kala e Dodës
- L. D. me detyrë ish Përgjegjës i Degës Financës aktualisht specialist i financës në Njësinë Administrative Kala e Dodës.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE:

C.1.Mbi gjobat e rekomanduara në Agjencisë Prokurimit Publik.

Referuar parregullsiave dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2016, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **KLSH me shkresën** nr. 733/13, datë 23.12.2016 i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik E. A. të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për 12 persona.

Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 30, datë 10.03.2017, përçjellë në Bashkinë Dibër dhe KLSH me shkresën nr. 733/20, datë 15.03.2017, e cila nuk u gjet e protokolluar në Bashkinë Dibër. Fotokopje e kësaj shkrese u paraqit nga grupi i auditimit të KLSH duke i lënë detyrë Bashkisë Dibër për t'ja bërë prezent APP dhe deri në kthimin e përgjigjes veprimet të kryhen me fotokopje shkrese.

Sipas kësaj shkrese nga APP është vendosur masa dënim me gjobë për 7 persona në shumën **1,000,000 lekë**, për të cilat KLSH i rikërkon Bashkisë Dibër ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit për pagesën e 7 vendimeve të gjobave të vendosura nga APP në shumën prej 1,000,000 lekë.

Menjëherë

C2. Masa Administrative për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor

Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, KLSH i rikërkon **Kryeinspektorit të Inspektoratit Të Mbrojtjes Territorit të Bashkisë Dibër** ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit për pagesën e 2 vendimeve të gjobave të vendosura nga IMTV në shumën prej 700,000 lekë, **për 2 mbikëqyrësit e punimeve si më poshtë:**

- 1. Sh. Gj.** mbikëqyrëse e punimeve, me gjobë në masën 500,000 lekë.
- 2. G. I.** mbikëqyrësi i punimeve me gjobë në masën 200,000 lekë.

Menjëherë

3.KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar 7 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë në proces zbatimi 2 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative për të cilat rikërkojmë zbatimin si më poshtë;

3/7.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH, sipas shkrësës nr. 444/6, datë 06.09.2013, për arkëtimin nga 20 punonjës të vlerës prej **1,120,239 lekë**, si pagesa të përfituara tepër.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej **5,231,856 lekë** deri më datën 25.10.2017 është arkëtuar vlera prej 125.667 lekë duke mbetur pa u arkëtuar edhe vlera prej 5.106.349 lekë nga e cila vlera prej 4,554,052 lekë është në proces gjyqësor.

Nga verifikimi rezulton se shuma e mësipërme prej 5,231,856 lekë është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 46 –debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2016. Nga 6 masa shpërblim dëmi 2 masa nuk janë pranuar, ndërsa 4 masa janë në proces.

Nga verifikimi rezultoi se deri më datën 25.10.2017 nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën **5,231,856 lekë**,

-Janë arkëtuar vlera.....125,667 lekë

Pa u arkëtuar deri më dt.25.10.2017.....5,106,189 lekë

Nga e cila:

-Janë në proces gjyqësor për operatori “E.....” sh.p.k.....4,554,052 lekë

-Janë nisur njoftimet por ende nuk ka filluar arkëtimet.....355,637 lekë

-Nuk pranohen, nuk janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë dhe nuk janë kontabilizuar vlera 199.500 lekë, për të **cilat rikërkojmë** si më poshtë;

1/2.1.Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë të kontabilizojë detyrimin dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e kësaj vlere respektivisht nga B. L. për vlerën 185,520 lekë, dhe L. T. për vlerën **84,317 lekë**.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan shpenzime të kryera në kundërshtim me kërkesat ligjor për vlerën prej **130,000 lekë**, sipas urdhër shpenzimit nr. 275, datë 04.6.2015, shpenzuar për një darke me rastin e mbylljes të Festivalit Folklorik Kombëtar Gjirokastrë, me pjesëmarrjen e 145 personave të Këshillit Qarkut Gjirokastrë dhe rretheve tjera, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar (*Trajtuar në faqen 18-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë të arkëtojë nga Kryetari i Qarkut S. M. dhe Shefi i Financës V. M. vlerën prej **130,000 lekë**, shpenzime të paligjshme për dreka, sipas urdhër shpenzimit nr. 275, datë 4.6.2015.

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Këshilli i Qarkut me Vendimin nr. 1 dt. 15.01.2017 “Për miratimin e plan programit në zbatim të rekomandimeve të KLSH” **ka rrëzuar këtë pikë** me argumentin se:

- Në bazë të Statutit të FFK Gjirokastrë (miratuar nga Ministria e Kulturës), e më konkretisht nenit 3,18,19 të tij në të cilat parashikohet shprehimisht: *kryerja e veprimtarive artistike në zonën muzeale me qëllim promovimin e vlerave kulturore artistike*.

- Në mbështetje të shkresës nr. 4658 Prot. Datë 13.10.2014 të Ministrisë së Kulturës, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, ka miratuar në Vendimin Nr. 7 dt. 08.01.2015 “Për miratimin e Buxhetit të Këshillit i Qarkut Gjirokastrë për vitin 2015” në zërin “Shpenzime të tjera operative” 602.9 fondin prej 1,200,000 lekë për financimin e këtij aktiviteti krahas fondit prej 800.000 lekë akorduar nga Ministria e Kulturës me shkresën nr. 5036/1 prot. të datës 09.12.2014.

Për sa sipër KLSH nuk është dakord dhe rikërkon zbatimin e rekomandimit

2/3.1.Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë të arkëtojë nga ish Kryetari i Q. S. M. B. dhe Shefi i Financës V. M. vlerën prej **130,000 lekë**, shpenzime të paligjshme për dreka, sipas urdhër shpenzimit nr. 275, datë 4.6.2015.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE:

Nga rekomandimi i APP për vendosjen e gjobave ndaj 4 personave në **shumën 210.000 lekë**, 3 punonjës e kanë atakuar në Gjykatë vendimin e APP-së, ndërsa për G. M., inxhinier i jashtëm në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, APP me vendimin nr. 34, datë 13/03/2017 ka vendosur gjobë në masën 60,000 lekë dhe nga verifikimi rezultoi se nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë nuk kanë filluar procedurat e njoftimit për të cilën **KLSH kërkon që** të njoftohet personi përkatës dhe të vazhdojnë procedurat e tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

4. PREFEKTURA KORÇE

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Prefekturës Korçë 23 masa organizative. Nga këto, nuk janë pranuar 11 masa organizative, dhe janë pranuar 12 masa organizative nga të cilat janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 7 masa organizative.

Duke qenë se Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Titujve të pronësisë Prefektura Korçë nga 23 masa organizative të rekomanduara gjithsej, nuk pranon 11 masa organizative të rekomanduar nga KLSH ose rreth gjysmat e tyre, (duke paraqitur rast pas rasti argumente dhe interpretime ligjore të ndryshme me arsyetimin se KLSH), KLSH i qëndron rekomandimeve të dërguara me shkresën nr. 678/46 Prot. datë 19.01.2017). Ndërsa për 7 masat organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, duhet të merren masa për zbatimin e tyre **për të cilat rikërkojmë** si më poshtë:

1/1.1.Rekomandim Sektori i Financës të marrë masa, të ndjekë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e shumës 36,421 lekë nga M. M. dhe në shumën 20,000 lekë nga “R.....”.

Menjëherë

2/4.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të regjistroj në procesverbalin e mbledhjes diskutimet e Prefektit, si dhe Prefekti, të thërras në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut dhe drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen, si dhe të regjistrohen diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët duhet të shprehin mendimet e tyre, si dhe nuk ka përcaktuar arsye që i bëjnë të pa vlefshëm ose absolutisht të pavlefshëm AMTP.

Menjëherë

3/7.1 -Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të përcaktoj në vendim kalimi në pronësi shtet të tokës së përfutur në kundërshtim me ligjin, nga personat fizik dhe juridik.

Menjëherë

4/8.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë në dorëzim tokën e liruar nga persona të cilët e kanë përfutur në mënyrë të paligjshme, si dhe t'ia dorëzojë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarkun Korçë (DAMT).

Në vijimësi

5/10.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 280, datë 30.01.2013 për pasurinë me sipërfaqe **300 m2 truall** me emërtimin “T.....” dhe vendimin nr. 288, datë 29.03.2013, për pasurinë me emërtimin “Mal” të AMTP nr. 4443, datë 20.02.1993 dhe sipërfaqen prej **300 m2** tokë të kaloj në pronësi shtet.

Në vijimësi

6/11.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 290, datë 30.04.2013 të AMTP nr. 4810, datë 20.02.1993 dhe sipërfaqen prej **800 m2** tokë të përfutur më shumë se norma për frymë dhe vendimin nr. 324, datë 20.01.2014 dhe të shprehet për sipërfaqen **400 m2**, i cili ndodhet brenda vijës kufizuese të fshatit Zemblak në zërin kadastral “Truall” dhe ti kaloj në pronësi shtet.

Menjëherë

7/12.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 329, datë 21.02.2014, dhe sipërfaqen **300 m2**, i cili me datë 01.08.1991, ndodhet brenda vijës kufizuese të fshatit Ravonik në zërin kadastral “Truall” dhe

të filloj kontrollin e drejtpërdrejtë, të ushtruar me nismën e vet, edhe për **15 pasuri** të ndara në zërin kadastral “Përrua”.

Menjëherë

8/13.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 384, datë 26.02.2015, për vlefshmërinë ligjore të pasurive rreshti **2, 4, 5, 6, 7, 8**, të AMTP nr. 6007, datë 20.05.1993, lëshuar në emër të z. P.P. dhe vendimin nr. 401, datë 29.06.2015, për vlefshmërinë ligjore të pasurive rreshti **2, 3, 4, 5, 6**, të AMTP nr. 5981, datë 08.05.1993 lëshuar në emër të Th. S, fshati Voskopojë.

Menjëherë

9/14.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 297, datë 28.06.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP pa numër dhe datë 27.05.1997 me sipërfaqe **8900 m2** dhe vendimin nr. 298, datë 28.06.2013 dhe të shqyrtoj vlefshmërinë ligjore të AMT P 344, datë 18.10.1990, me sipërfaqe **120 m2** dhe të bëjë kalimin e tyre në pronësi shtet.

Menjëherë

10/15.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 299, datë 28.06.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP pa numër, datë 17.10.1996, me sipërfaqe **14970 m2** dhe vendimin nr. 300, datë 28.06.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP pa numër, datë 17.10.1996, me sipërfaqe **15670 m2**, duke zbatuar procedurat e përcaktuar në duke zbatuar procedurat e përcaktuar në kreun A pika 1/2, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Menjëherë

11/16.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 301, datë 10.07.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 803, datë 20.10.2000, me sipërfaqe 1100 m2 dhe vendimin nr. 305, datë 10.07.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 170, datë 18.06.1993, me sipërfaqe 4500 m2, duke zbatuar vendimin nr. 3, datë 04.02.1994, të KRRTRSH-së dhe kalimin në pronësi shtet.

Menjëherë

12/17.1-Rekomandim: Komisioni vendor të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 307, datë 10.07.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 667, datë 28.06.1999, me sipërfaqe **15000 m2** dhe vendimin nr. 308, datë 10.07.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 698, datë 17.06.1996, me sipërfaqe **10000 m2**, duke zbatuar vendimin nr. 3, datë 04.02.1994, të KRRTRSH-së pasi parcela ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës dhe kalimin në pronësi shtet.

Menjëherë

13/18.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 358, datë 30.09.2014, mbi vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 38, datë 11.08.2000, me sipërfaqe **12000 m2** dhe vendimin nr. 341, datë 16.05.2014, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 169, datë 28.06.1996 dhe të AMTP nr. 169, datë 28.06.1996, me sipërfaqe **3000 m2**, duke zbatuar vendimin nr. 3, datë 04.02.1994, të KRRTRSH-së pasi parcela ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës dhe kalimin në pronësi shtet.

Menjëherë

14/19.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të zbatoj programin vjetorë për kontrollin e drejtpërdrejtë, të ushtruar me nismën e vet, dhe të miratuar nga Komisioni Qeveritar i Tokës Tiranë.

Në vijimësi

15/20.1-Rekomandim: Prefekti i Qarkut Korçë dhe KV (komisioni vendor) të marrin masat për rishqyrtim të 15 dosjeve për të cilat ka deklaruar përfundimin e procedimit administrativ duke marr një vendim në përmbushje të detyrës funksionale në zbatim të tagrit ligjor të përcaktuar nga neni 9 e në vijim të ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” të ndryshuar.

Menjëherë

16/21.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendim nr. 325, datë 20.01.2014, për korrigjimin e AMTP nr. 118, pa datë në emër të M.U, vendimin nr. 330, datë 21.02.2014, për korrigjim e AMTP nr. 134, pa datë në emër të MU dhe vendimin nr. 388, datë 13.03.2015, për korrigjim e AMTP nr. 326, pa datë në emër të A.U pasi DAMT-Qarkut Korçë konfirmon zërin kadastral tokë pafrytshme “P. F”.

Menjëherë

17/22.1-Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendim nr. 414, datë 22.10.2015, me sipërfaqe 205 m2 tokë dhe kalimin në pronësi shtet, pasi L. Sh. nuk ka blerë tokën e përfituar mbi normën për frymë në fshatin Libonik.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” pikën 39 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e titullarit të njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, shpenzime të cilat vijnë në mospërputhje me 3 E-të (ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet). **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 635,215 lekë, si më poshtë:**

1.1-Rekomandimi: Sektori i Financës pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, të marrë masa të ndjekë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e shumës **368,673 lekë**, nga A. K. me detyrë Nënprefekt i Rrethit Devoll dhe shumën **266,542 lekë**, nga L. M. me detyrë Nënprefekt i Rrethit Pogradec.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

C-I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Bazuar në nenin 15 shkronja (c) të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” shkronjat (b dhe c), të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 datë 18.12.2014; Kreu I-Organet Disiplinore, pikat 3 dhe 10, të VKM nr. 115 datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i KLSH i **ka rekomanduar** Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërktojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë që për **4 punonjës**, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore nga “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj deri në “Pezullim nga e drejta për ngritjen në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës deri në dy vjet”, parashikuar në nenin 58 shkronja (b) dhe (c),

Nga verifikimi rezulton se Komisioni Disiplinor pasi i ka marrë në shqyrtim masat e rekomanduara nga KLSH duke thirrur edhe një punonjës të DAP dhe ka vendosur për mos fillimin e masave disiplinore për **punonjësit si më poshtë:**

1. M. F. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;

- Mos bërjen hyrje në magazinë të materialeve jashtë përdorimit, veprim në papajtueshmëri me pikën 109, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe pikën 5, të UMB nr. 1151, datë 16.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme”.

- Mos kërkimin ndaj komisionit të asgjësimit për marrjen e materialeve për asgjësim me fletë dalje nga magazina, veprim në papajtueshmëri me nenin 3, pika 2 dhe nenin3, të ligjit nr. 10296, datë 08.10.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikën 108 dhe 122 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe pikën 5 të UMB nr.1151, datë 16.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme”.

- Mos respektimin e procedurave ligjore mbi shpenzimin e karburantit me vlerë **635.215 lekë**, përdorur nga Nënprefekti i Rrethit Devoll dhe Pogradec, veprim në papajtueshmëri me nenin 127, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe germën **f**, neni 12, të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

2. T. Xh. me detyrë specialist i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;

-Mos bërja hyrje në magazinë e materialeve jashtë përdorimit, veprim në papajtueshmëri me pikën 109, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe pikën 5 të UMB nr.1151, datë 16.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme”.

- Mos kërkimin ndaj komisionit të asgjësimit për marrjen e materialeve për asgjësim me fletë dalje nga magazina, veprim në papajtueshmëri me nenin 3, pika 2 dhe nenin3, të ligjit nr. 10296, datë 08.10.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikën 108 dhe 122 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe pikën 5 të UMB nr.1151, datë 16.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme”.

3. D. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik;

-Mos respektimin e procedurave ligjore mbi shpenzimin e karburantit me **vlerë 635.2015 lekë** (e përdorur nga Nënprefekti i Rrethit Devoll dhe Pogradec, veprim në papajtueshmëri me nenin 127, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe germën **f**, neni 12, të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

4. F. R. me detyrë specialiste në Sektorin e Kontrollit Vendor, në cilësinë e anëtarit të KVO;

-Mos respektimin e procedurave ligjore në tenderin e vitit 2013 me objekt “Shërbimi i rojeve dhe sigurisë fizike” me fond limit 1,147,000 duke kualifikuar ofertën e cila nuk plotëson kriteret për kualifikim, veprim në kundërshtim me nenet 46, 53 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe kreu V, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Menjëherë

C-II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenet 37,141,153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe nr. 125, datë 29.07.2003, ligjin nr. 9948 datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore të ndryshuar”, KLSH i ka **rekomanduar Prefektit të Qarkut Korçë**, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Zgjidhjen e kontratës së punës”, për 6 punonjësit, por nga verifikimi rezulton se ndaj tyre është marrë masa disiplinore “Vërejtje” dhe konkretisht:

1. S. K. me detyrë Drejtor i komisionit vendor, për shkelje në 37 raste;
2. H. G. me detyrë specialist në komisionin vendor, për shkelje në 16 raste;
3. E. R. me detyrë specialist në komisionin vendor, për shkelje në 4 raste;
4. O. G. me detyrë specialiste në komisionin vendor, për shkelje në 8 raste;
5. J. D. me detyrë specialist në komisionin vendor, për shkelje në 3 raste;
6. L. S. me detyrë specialiste në komisionin vendor, për shkelje në 1 rast;

Menjëherë

5.NDËRMARRJA BALNEARE (Lixhave) PESHKOPI

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH janë rekomanduar 8 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 5 masa dhe janë në proces zbatimi 3 masa organizative, për të cilën rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:

1/2.1.Rekomandimi: Zyra e Financës së Ndërmarrjes të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrimit të aktiveve të qëndrueshme dhe të plotësohet me të dhënat e nevojshme, për çdo aktiv në veçanti, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

2/4.1.Rekomandimi: Nga titullari i ndërmarrjes dhe nga Këshilli Drejtues, të merret në analizë raportimi financiar jo i saktë duke reflektuar masa konkrete për organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar. Nga zyra e financës, të sistemohen llogaritë financiare duke proceduar sipas kërkesave ligjore, me qëllim që kontabiliteti të pasqyrojë gjendjen reale sipas rezultateve të inventarizimit fizik dhe gjendjen monetare sipas ekstraktit të bankave.

Menjëherë

3/8.1.Rekomandimi: Qendra Balneare, të marrë masat për të aplikuar taksën e larjes ndaj çdo klienti në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar dhe të paketës fiskale të miratuar me vendime të Këshillit të Bashkisë Dibër.

Në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI:

Nga KLSH i është rekomanduar Ndërmarrjes Qendra Balneare Dibër shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **1,194,184 lekë**. Nga verifikimi rezultoi se shuma prej 1,194,184 lekë është regjistruar në kontabilitet dhe deri më datën 18.10.2017 janë arkëtuar **16,500 lekë**, duke mbetur pa u arkëtuar edhe **1,177,684 lekë** e cila është në proces gjyqësor. Nga 3 masa shpërblim dëmi 1 masë është zbatuar dhe 2 janë në proces gjyqësor.

1/1.1.Rekomandimi: Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **1,147,684 lekë** nga ish Drejtori I. Q. për periudhën 1.01.2013 -31.08.2015.

Menjëherë

2/2.1.Rekomandimi: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **30,000 lekë** nga ish Drejtori I Q. për përfitim të padrejtë të kompensimit për shërbimin e transportit.

Menjëherë

6. BASHKIA KËLCYRË

A.MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Këlcyrë 20 masa organizative, është zbatuar plotësisht 1 masë, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 18 masa organizative, për të cilat rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:

1/1.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Të ngrihet GMS, të hartohet regjistri i riskut dhe në mënyrë periodike të analizohen dhe merren masa për risqet që rrezikojnë realizimin objektivave. Të hartohet rregullore për kodin e etikës dhe zbatimin e ligjit për arkivat. Për proceset kryesore të punës të hartohet gjurma e auditimit.

Menjëherë

2/2.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për krijimin e regjistrit kontabël të aktiveve në administrim si dhe të krijojë regjistër të veçantë për pasuritë e dhëna me qira ku të evidentohen të gjitha të dhënat e nevojshme sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë

3/3.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë të ndërpresë praktikën e dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi rezervë për persona të cilët nuk janë pjesë e skemës të ndihmës ekonomike.

Menjëherë

4/4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, nëpërmjet Njesisë të Burimeve Njerëzore të marrë masat dhe të zbatojë procedurat e rekrutimit në punë të punonjësve, sipas kërkesave të legjislacionit. Në rastet e marrjes në punë të punonjësve për plotësimin e vendeve vakante, pozicioni i të cilëve mbulohen nga statusi për nëpunësin civil, njësia e burimeve njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të zbatojnë të gjitha procedurat e rekrutimit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

5/6.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyrë (Njësia Administrative Dishnicë), të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e 4 dosjeve të procedurave të prokurimit publik, si dhe Zyra e Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Menjëherë

6/7.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, me qëllim arkëtimin e taksave vendore, të përgatisë dhe paraqesë për miratimin në Këshillin Bashkiak akt-marrëveshjen me shoqërinë “U.....” sh.a, duke i dhënë të drejtë shoqërisë të kryejë rolin e agentit tatimor, duke arkëtuar bashku me faturën e ujit të pijshëm edhe taksat dhe tarifatat vendore.

Menjëherë

7/8.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, për arkëtimin e detyrimeve tatimore prej **42,297 mijë lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore në RSH”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në RSH “ të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten në vazhdimësi kamat vonesa.

d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të evidentojë dhe njoftojë familjarët për të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 71, të UMF nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

f- Zyra e Financës të kontabilizojë detyrimin për taksë dhe tarifa vendore në vlerën 38,373 mijë lekë dhe në bashkëpunim dhe me zyrën e taksave të administrojë edhe listat e debitorëve.

Menjëherë

8/9.1 Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të filloj procesin për studimin, hartimin dhe miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Menjëherë

9/10.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për evidentimin e pronave të ish-Bashkisë Këlcyrë dhe 3 Njësive Administrative, ish-Komunat, Dishnicë, Suk, Ballaban, të kryej inventarizimin, vlerësimin, kontabilizimin, pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme të pasqyrave financiare dhe të marrë masa për regjistrimin e të gjitha aseteve në ZVRPP Përmet.

Menjëherë

10/11.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për vënien në efikasitet të objekteve dhe sipërfaqeve të truallit të pa shfrytëzuar duke rritur përpjekjet menaxheriale për dhënien e tyre me qira.

Në vijimësi

11/12.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe krijojë komisionin për marrjen në dorëzim të aseteve nën administrim, duke hartuar proces-verbalin e marrjes në dorëzim të pronave, akt i cili duhet të nënshkruhet nga dorëzuesi i pronës dhe përfituesi (Bashkia Këlcyrë), si dhe duhet të shoqërohet me tregues dhe element teknikë si harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre etj.

Menjëherë

12/13.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë të derdhë për llogari të buxhetit të shtetit detyrimin prej **419,500 lekë**, si tatim në burim, realizuar nga arkëtimi i të ardhurave nga qiratë e objekteve.

Menjëherë

13/14.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për vendosjen e gjobave dhe arkëtimin e tyre në vlerën **11,500,000 lekë**, për rastet e shkeljeve në ndërtimet pa leje dhe të dokumentuara nëpërmjet proces-verbaleve dhe vendimet të marra nga IMT Bashkia Këlcyrë.

Menjëherë

14/15.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të vërë në efijencë strukturën e policisë bashkiake. Të kërkoj nga Këshilli Bashkiak miratimin e nivelit të gjobave sipas llojit të shkeljeve administrative.

Menjëherë

15/15.2. Rekomandim: Policia Bashkiake, të përgatisë dhe plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për pasqyrimin e veprimtarisë së përditshme. Struktura e policisë bashkiake nëpërmjet urdhrave të titullarit dhe kërkesave të sektorëve përkatës të vihet në mbështetje të strukturave të tjera të bashkisë për kontrollin e territorit, vjeljen e taksave vendore, administrimin e aseteve etj.

Menjëherë

16/16.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë të ndjekë të gjitha hapat ligjore për vjeljen e vlerës 326,252 lekë nga 38 ish-punonjës të ish-komunës Ballaban, sipas listave analitike që disponohen në arkivin e bashkisë.

Në vijimësi

17/17.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për kthimin dhe ruajtjen e makinerive, autoveturave apo dhe pajisjeve në ambientet nën administrim të institucionit apo pikë magazinimi e ruajtje në mbikëqyrje dhe kontrollin e tij; të bëj inventarizim të hollësishëm të mjeteve duke përcaktuar gjendjen fizike, mekanike, motorike, etj dhe në rast konstatimi të mangësive apo dëmtimeve fizike apo mekanike, të ngarkohet/en me përgjegjësi materiale personi/at përgjegjës sipas rregullave në fuqi.

Në vijimësi

18/18.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të ngrëjë komision me specialistë të fushës, për vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të mjetit të ish-Komunës Ballaban, dhe pas raport vlerësimit të gjykojë dhe vlerësoj mbi gjendjen e mjetit, nevojën për mbajtjen e tij në punë, për vijimin e procedurave ligjore për nxjerrjen e tij në ankand.

Menjëherë

19/19.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të bëjë hyrje pompën e ujit me vlerë 300,000 lekë, pasi nuk është administruar nëpërmjet magazinës, sipas urdhër shpenzimit nr. 264, datë 29.10.2015.

Menjëherë

20/20.1.Rekomandimi: Bashkinë Këlcyrë, të zbatojë rekomandimet e mëparshme të KLSH, sipas shkresave nr. 434/53, datë 01.07.2013 dhe nr. 351/68, datë 2.2.2011, duke kontabilizuar dhe ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **4,096,510 lekë**, përkatësisht:

1. B. A. 218,751 lekë,
2. V. C. 23,065 lekë,
3. H. SH. 23,065 lekë,
4. "H..... shpk" 500,000 lekë,
5. "B...." shpk 574,360 lekë,
6. "K" shpk 838,172 lekë,
7. "B " shpk 165,800 lekë,
8. "R" shpk, 753,271 lekë
9. vlera 1,000,026 lekë nga 26 persona sipas listës të administruar në Bashkinë Këlcyrë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga 25 masa të rekomanduara në vlerën prej **21,744,494 lekë** është pranuar vlera e rekomanduar për shpërblim dëmi por deri më datën 17.11.2017 kur është kryer verifikimi nuk është arkëtuar asnjë lekë duke mbetur pa u arkëtuar edhe vlera prej **21,744,494 lekë**, nga e cila vlera prej 7,504,606 lekë nuk kishte filluar arkëtimi. Ndërsa për vlerën prej **14,239,494 lekë**, të cilat u përkasin mos kryerjes se punimeve në 5 subjekte nuk ishin nxjerrë urdhrat e zhdëmtimit me arsyetimin se Bashkia Këlcyre nuk mund të shprehet pasi pritet një vendim përfundimtar nga organi i prokurorisë së rrethit gjyqësor Përmet. Me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH nga Bashkia Këlcyre u nxorën urdhrat e ekzekutivë duke dërguar subjekteve me shkresën nr. 1534, prot dt.08.11.2017.

Gjithashtu nga verifikimi rezultoi se nuk ishte kontabilizuar dhe nuk ishte pasqyruar në llogarinë 468 – debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2016 (bilanci vjetor 2016). **Për sa sipër KLSH rikërkon** që për 25 masat për shpërblim dëmi në vlerën **21,744,494 lekë** të konsideruara në proces zbatimi të fillojnë ndalesat ndaj punonjësve të punësuar në Bashkinë Këlcyre dhe nga Drejtoria Juridike për personat të cilët nuk kanë pranuar të paguajnë në mënyrë vullnetare të hartohen paditë gjyqësore për shpërblim dëmi në vlerën **21,744,494 lekë**. Dhe këto detyrime pasi të kalojnë afatet e ankimimit të regjistroheshin si debitorë në kontabilitet duke i pasqyruar në llogarinë 468 – debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2017 (bilanci vjetor 2017).

Në mënyrë të detajuar masa për shpërblim dëmi paraqiten më poshtë :

1/1.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyre, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **6,392,567 lekë** pa t.v.sh nga BOE “R...” sh.p.k dhe “E.....” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën datë 31.05.2016 me objekt “Skema ujitëse dhe ujitja e fushës Ballaban”, Këlcyre”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2/2.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyre, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **4,857,219 lekë** pa t.v.sh nga BOE “R...” sh.p.k dhe “H.....” shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën datë 05.06.2013 me objekt “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Katundisht (faza 2)”, Dishnicë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3/3.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyre, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,699,578 lekë** pa t.v.sh nga BOE “H..... 94” sh.p.k dhe “L.....” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën datë 25.01.2016 me objekt “Sistemim Asfaltim Unaza Këlcyre Qendër - faza e II-të” Këlcyre, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4/4.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyre, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **625,944 lekë** nga OE “H.....” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 30.07.2014 me objekt “Sistemim Asfaltim Unaza Këlcyre Qendër - faza e I Këlcyre, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5/5.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyre, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **664,500 lekë** pa t.v.sh nga OE “H.....” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 30.07.2014 me objekt “Rikonstruksion i rrugës Tolar, Leskovec, Mertinj” Këlcyre, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6/6.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **453,685 lekë** pa t.v.sh nga OE “M.....” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 11.07.2014 me objekt “Ndërtimi i urës në fshatin Vinokash” Këlcyrë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

7/7.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **220,218 lekë**, për punë të pakryer nga firma e pastrimit “S”, pasi ka përfituar padrejtësisht zërat e punës “Pastrim i Parë i Unazës Këlcyrë Qendër të Qytetit” dhe “Mirëmbajtje Rrugë e Sheshe”, për periudhën nga data 25.8.2014 deri më 28.2.2015, për arsye se unaza e qytetit i ishte nënshtruar rikonstruksionit dhe asfaltimit, sipas kontratës nr. 4985, datë 30.7.2014.

Menjëherë

8/8.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **514,068 lekë**, nga subjekti “H... shpk”, përfituar 2 herë TVSh në zërin “makineri e pajisje”, në objektet “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Kamber Benja Këlcyrë” dhe “Sistemim lulishte Këlcyrë”.

Menjëherë

9/9.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **128,412 lekë**, nga preventives “S” shpk me përfaqësues G. P. për arsye se ka rritur vlerën e preventivit për zërin nr. 4.60 analizës, çmimi i F.V.tuba çeliku $\Phi 600/6.3$ mm L=20m, për sasinë prej 7.48 ton, në objektin “Skema ujitëse dhe ujitja e fushës Ballaban” Këlcyrë, për vitin 2015.

Menjëherë

10/10.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e detyrimit **634,234 lekë**, nga 21 ish-këshilltarët dhe këshilltarët aktual të këshillit bashkiak, sipas listës trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

11/11.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **63,500 lekë** për G. H. si pagesë e përfituar tepër.

Menjëherë

12/12.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **2,150,400 lekë** nga Kompania V sh.a, si rezultat i mos aplikimit të drejtë të tarifës së qirasë për vendosje antene të telefonisë të lëvizshme.

Menjëherë

13/13.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **574,700 lekë**, nga anëtarët e KVO përkatësisht:

1. E. Z. në vlerën 143,675 lekë
2. A. M. në vlerën 143,675 lekë
3. R. S. në vlerën 143,675 lekë
4. B. F. ish Titullari i AK në vlerën 143,675 lekë

Për diferencë të krijuar nga skualifikimi i ofertës më të ulët dhe asaj të shpallur fituese në tenderin “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Katundishtë”.

Menjëherë

14/14.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **40,000 lekë** nga D. V. si shpenzim i pajustificuar për blerjen e 2 fenerëve.

Menjëherë

15/15.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **141,000 lekë** nga B. F. ish-Kryetar i Komunës Dishnice dhe R. S. ish-përgjegjëse financës nga 70,500 lekë secili, për shpenzim të paligjshëm për pritje përcjellje me rastin e festës së Çlirimit të Atdheut.

Menjëherë

16/16.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **808,000 lekë** përfitim të pa drejtë **dieta** për vitet 2013-2015 sipas urdhër shpenzimeve përkatëse, konkretisht:

1. **B. F.** në vlerën 323,500 lekë,
2. **R. S.** në vlerën 99,000 lekë,
3. **E. I.** në vlerën 155,500 lekë,
4. **A. L.** në vlerën 50,000 lekë,
5. **P. J.** në vlerën 107,000 lekë,
6. **A. M.** në vlerën 33,000 lekë
7. **D. V.** në vlerën 40,000 lekë.

Menjëherë

17/17.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **172,619 lekë** për shpenzime celulare të përfituara padrejtësisht për periudhën 2013- 2015, nga:

1. **B. F.** në vlerën 145,619 lekë,
2. **E. I.** në vlerën 6,000 lekë,
3. **D. V.** në vlerën 6,000 lekë,
4. **A. M.** në vlerën 5,000 lekë,
5. **N. Sh.** në vlerën 4,000 lekë,
6. **H. H.** në vlerën 2,000 lekë,
7. **S. B.** në vlerën 3,000 lekë
8. **A. Rr.** në vlerën 1,000 lekë.

Menjëherë

18/18.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **135,000 lekë**, për mungesë inventari të 2 pajisjeve kompjuterike, nga **B. F.** 105,000 lekë dhe **R. S.** në vlerën 30,000 lekë.

Menjëherë

19/19.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **130,000 lekë**, përkatësisht: A. D. ish-Kryetar i Komunës për 75,000 lekë dhe DH. A Ish-Përgjegjëse e Financës për 55,000 lekë, për dieta të përfituara në kushtet e një dokumentacioni të parregullt dhe të pajustificuar.

Menjëherë

20/20.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **33,330 lekë**, shpenzim i paligjshëm, për koktej me rastin e festave të fund vitit, përkatësisht nga A. D. dhe DH. A në vlerën 16,665 lekë secili.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: U konstatua se në ish-**Komunën Ballaban** është kryer shpenzim për “Riparime rrugësh të brendshme Ballaban”, për vlerën **320,700 lekë dëm ekonomik**, pa miratim në Këshillin e Komunës, në mungesë të dokumenteve vërtetuese dhe fotografimeve para dhe pas punimeve objektit, si dhe me situacion të nënshkruar jo nga specialistë të fushës por nga ish-kryetari komunës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar dhe kreun IV shkronja C me UAPP nr. 02, datë

28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 1 dhe 4, ndryshuar me UAPP nr. 5, datë 16.7.2013 dhe nr. 01, datë 28.02.2014 (Trajtuar në faqet 126-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **320,700 lekë** nga **A. D. dhe DH. A**, për shpenzim të argumentuara dhe justifikuara me dokumentacion ligjor, si dhe të **pa miratuar në Këshillin e Komunës**.

21.2. Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhrin e kryetarit të Bashkisë Këlcyrë K. N. nr. 212, prot, dt.21.06.2016 janë njoftuar personat për shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën 320,700 lekë. Por deri më datën 17.11.2017 në të cilën është kryer verifikimi nuk është arkëtuar asnjë lekë.

Në proces zbatimi

Komentet dhe shpjegimet e DH. A. ish- shefes financës komuna Ballaban , për këtë rekomandim citoi:

Shuma prej 160.350 leke për arsyeje se është kryer shpenzim i paargumentuara dhe i pajustificuar si dhe i pamiraturar ne Këshillin e Komunës per mirëmbajtje rrugësh . sipas urdhër shpenzimit nr.112, dt.23.06.2015 për vlerën 320,700 lekë.

Citoi: *Ju sqarohet se shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve të brendshme ish komunës Ballaban për vlerën **320,700 lekë** është bërë me procedurë prokurimi blerje të vogla elektronike sipas urdhër prokurimit nr. 08, dt.15.05.2015,zhvilluar më dt.16.05.2015 ku është paraqitur Ftesa për ofertë. Për zhvillimin e procedurës prokurimit është mbajtur procesverbali dt. 10.05.2015 me pjesëmarrjen e 3 anëtarëve të komisionit respektivisht: DH. A, A. SH. dhe F. C., tender i cili është anuluar dhe përsëritur më datën 25.05.2015 ora 12,sipas procesverbalit dt. 25.05.2015, proces verbali i dorëzimit të objektit “ Mirëmbajtje rrugëve” me vlerë 320,700 lekë, në proces verbalin e dorëzimit kanë firmosur një komision i përbërë prej 3 personash, respektivisht: F. C. A. M. dhe E. B. .*

Nga grupi i auditimit të KLSH është shkruajtur se për këtë procedurë prokurimi nuk ka vendim të këshillit të Komunës, gjë që nuk është e vërtetë dhe nuk qëndron, pasi në Buxhetin e Komunës Ballaban te vitit 2015 është i miratuar fondi per mirëmbajtje rrugësh ne vendimin e Keshillit nr. 11,date 23.03.2015 e miratuar ne Prefektura Gjirokastër me nr. prot 875/1 date 07.04.2015 ku është e pasqyruar te tabela e detajimin te shpenzimeve operative per vitin 2015 te zëri mirëmbajtje rruge ne shumen 395,000 leke.

Përsa i përket procedurës gjykojmë se dokumentet janë te sakta e te justifikuara e te rregullta duke u pajisur me urdhër prokurimi, preventiv te firmosur nga specialist i fushës ne rastin e sipërpërmendur S. Sh. dhe situacion te firmosur nga sipërmarrësi e titullari i komunës. Punimet e kryera janë mare ne dorëzim nga komisioni i ngritur nga titullari, dokumentet te cilat janë nxjerr nga arshiva e Bashkisë Këlcyrë dhe po ja u paraqesim per prova bashkëlidhur me këtë observacion.

Përfundimisht ky rekomandim nuk pranohet nga subjekti dhe kërkohet rivlerësimi i tij.

Menjëherë

22/22.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **121,320 lekë**, tejalim normative të karburantit, përkatësisht nga drejtuesi i mjetit **A. M. magazinieri E. B. përgjegjësia e financës DH. A. si dhe ish-kryetari i komunës A. D.** nga 30,330 lekë secili.

Menjëherë

23/23.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **150,000 lekë** nga ish kryetari i Komunës Sukë G. M.

Menjëherë

24/24.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **367,500 lekë**, dieta të pajustificuara dhe përfituara nga **G. M.** në vlerën **302,500 lekë**, **H. SH.** në vlerën **32,000 lekë**, **E. H.** në vlerën **33,000 lekë**.

Menjëherë

25/25.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **346,000 lekë** si shpenzime karburanti të pa argumentuara dhe justifikuara nga **G. M.** dhe drejtuesi i mjetit **S. K.**.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE:

C.1.Mbi gjobat e rekomanduara Agjencisë prokurimit Publik.

APP me vendimin nr. 35 datë 13.03.2017 ka përcjellë për në Bashkinë Këlcyrë dhe KLSH-në me shkresën nr. 734/15 datë 16.03.2017, e cila është protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr.317 prot datë 17.03.2017 ka vendosur masa dënimit me gjobe **për 9 persona në vlerën 590,000 lekë**, ndërsa për 18 persona të tjerë nuk është dhënë masë as dënimit me gjobë dhe as masa disiplinore, pasi këta janë ish punonjës të ish komunave të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të reformës administrative. Për vendimet e gjobave për 7 personat në vlerën **590,000 lekë KLSH kërkon ndjekjen** e procedurave ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit. Për vendimet e gjobave për 9 personat në vlerën 590,000 lekë nga bashkia Këlcyrë të merren masa për njoftimin e personave dhe arkëtimin e shumës.

Menjëherë

C.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Këlcyrë.

Referuar gjetjeve të konstatuara në fushën e ndërtimeve përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në proces-verbalet përkatëse, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 15 germat (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe bazuar në nenin 5/b, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ”Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 01.04.2013 ”Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” dhe nenin 15 ”Sanksionet”, dhe 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Bashkia Këlcyrë ne kushtet kur nuk ka krijuar Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor, duhet ti drejtohet zyrtarisht për vendosjen e gjobave **IMTV Rajonale Gjirokastër**, duke i dërguar edhe kopje të procesverbaleve të mbajtur nga KLSH **për 4 mbikëqyrësit e punimeve si më poshtë:**

1. Për A. P. në cilësinë e Projektuesit gjobë në masën **500,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 5,521,719 lekë pa tvsh ndaj buxhetit të shtetit si dhe preventivuar jo në përputhje me projektin e miratuar të zbatimit dhe me manualin teknik të çmimeve në fuqi vlera 12,467,282 lekë pa tvsh .

2. Për S. Sh. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve gjobë në masën 200,000 lekë, për shkeljet e konstatuara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 8,092,145 lekë pa tvsh.

3. Për **L. Th.** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve gjobë në masën 200,000 lekë, për shkeljet e konstatuara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 11,914,286 lekë

4. Për **K. I.** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve gjobë në masën 100,000 lekë, për shkeljet e konstatuara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 2,325,522 lekë pa tvsh.

Shënim: Shkeljet për secilin person janë trajtuar në faqet 49-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

7.BASHKIA VORE

A.MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar 17 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 9 masa, janë në proces zbatimi 6 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative nga masat organizative janë arkëtuar **gjithsej 21,868,000 lekë**, nga të cilat 10,585,000 lekë taksë ndikimi në infrastrukturë dhe 11,283,000 lekë ta ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore. Për 6 masat organizative të pazbatuara ri kërkojmë si më poshtë:

1/6.1.Rekomandim: Nga Bashkia Vorë, të kërkohet të azhurnohet e përditësohet kontrata bazë, me referencat ligjore të kohës dhe konkretisht VKM Nr. 54, Datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM Nr. 735, Datë 05.11.2014, VKM Nr. 445, Datë 20.05.2015, VKM Nr. 992, Datë 09.12.2015 dhe VKM Nr. 299, Datë 20.04.2016

Menjëherë

2/7.1.Rekomandim: Nga Bashkia Vorë, të kërkohet të azhurnohet e përditësohet kontrata bazë, me referencat ligjore të kohës dhe konkretisht VKM Nr. 54, Datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM Nr. 735, Datë 05.11.2014, VKM Nr. 445, Datë 20.05.2015, VKM Nr. 992, Datë 09.12.2015 dhe VKM Nr. 299, Datë 20.04.2016, si dhe kontrata të lidhet sipas përcaktimeve kohore të bëra nga Kodi Civil.

Menjëherë

3/8.1.Rekomandim: Bashkia Vorë, të hartojë dhe nënshkruajë kontratën e re me shoqërinë “V.....”, duke respektuar të gjitha kriteret ligjore e teknike të përcaktuara në VKM Nr. 54, Datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM Nr. 735, Datë 05.11.2014, VKM Nr. 445, Datë 20.05.2015, VKM Nr. 992, Datë 09.12.2015 dhe VKM Nr. 299, Datë 20.04.2016.

Menjëherë

5/15.1.Rekomandim: Nga ana e Sektorit të Taksave e Tarifave Vendore, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë të pa arkëtuar në vlerën **59,144 mijë lekë për sektorin e biznesit dhe të vlerës 19,251 mijë lekë për popullatën.**

Menjëherë

5/16.1.Rekomandim: Bashkia Vorë, nëpërmjet Zyrës Juridike dhe Drejtorisë Ekonomike, të ndjekë proceset gjyqësore ndaj subjekteve të cilat kanë ankimuar gjyqësisht masën e gjobës, si dhe subjekteve të cilat nuk e kanë ushtruar këtë të drejtë, ende nuk kanë filluar shlyerjen e gjobës.

Menjëherë

6/16.2.Rekomandim: Bashkia Vorë të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme duke i kërkuar Zyrës së Shërbimit Përmbarimor, ecurinë e arkëtimit të vlerës prej 8,000,000 lekë për vitin 2015 dhe 4,050,000 lekë për vitin 2016, vlerë e cila përbën të ardhura të munguar për buxhetin e NJQV Bashkia Vorë. Në referim të rezultateve konkrete të punës të Zyrës të Shërbimit Përmbarimor, në drejtim të arkëtimit të shumës prej 12,050,000 lekë të rishikoj sipas rastit marrëdhëniet e bashkëpunimit, deri në prishjen e kontratës.

Menjëherë

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Vorë shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **8,866,124 lekë** ose **8,474,968 lekë dhe 3,049\$** (391,156 lekë, konvertuar me kurs mesatar 128.29 lekë/\$) deri më datën 17.11.2017 është arkëtuar vlera prej **954,850 lekë**, janë kryer punimet e situacionuara por të pakryera nga subjektet në vlerën **6,108,600 lekë** duke mbetur pa u arkëtuar edhe vlera prej **1,802,674 lekë**.

Nga verifikimi rezulton se shuma e mësipërme prej **8,866,124 lekë ose 8,474,968 lekë dhe 3,049 \$** (391,156 lekë, konvertuar me kurs mesatar 128.29 lekë/\$) është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë r. 468 –debitorë të Pasqyrave Financiare më Datën 31.12.2016 (bilanci vjetor 2016) bashkëlidhur fotokopjen e ekstraktit të kontabilizimit) për të cilat **rikërkojmë** zbatimin e tyre si më poshtë:

1/3.1.Rekomandim: Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,796,400 lekë** pa tvsh për objektin “Rikonstruksion dhe Asfaltim i Rrugëve të Lagjeve në Kodër Vorë, Loti 1”, Bashkia Vorë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2/4.1.Rekomandim: Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,292,538 lekë** pa tvsh nga BOE “A.....” sh.p.k.& “E.....” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën Nr. 214/5, Datë 09.01.2015 me objekt “Rikonstruksion Sistemim dhe Asfaltim i Rrugëve të Brendshme të Fshatit Muçaj, Aksi 01”, Bashkia Vorë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3/6.1.Rekomandim: Nga Bashkia Vorë, të merren të gjitha masat dhe të aplikohen të gjitha procedurat për kërkimin e vlerës të kontratës së qirasë, si dhe të kërkohet të zbatohet pika e kontratës sipas të cilës për çdo ditë vonesë shoqëria duhet të paguaj penalitetet në vlerën prej 1% për çdo ditë, kamatëvonesë e cila llogaritet mbi nivelin bazë të qirasë. Për objektin sipas kontratës Datë 01.06.1994 lidhur ndërmjet shoqërisë “A.....” përfaqësuar nga E G dhe Degës së Agjencisë së Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore Tiranë, me referencë ligjore VKM Nr. 452, Datë 17.10.1992 dhe neneve 89 dhe 182 të Kodit Civil dhe qëllim përdorimi dhënia me qira e sipërfaqes së tokës është 9240 m², në fshatin Muçaj, për një periudhë prej 99 vjet, duke filluar nga 07.12.1992, është konstatuar se nuk është paguar detyrimi prej **3049 USD ose 391,156 leke** (Trajtuar në faqet 171-180 të Raportit të Auditimit).

Menjëherë

8.BASHKIA LIBRAZH

A.MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Librazhd 22 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 14 masa, nuk ka masa organizative të pazbatuara janë në proces zbatimi 8 masa dhe, për 4 nga të cilat rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:

1/3.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për analizimin e Raportit Final të auditimit të ushtruar nga njësitë e auditimit të brendshëm të Bashkisë Librazhd, në K..... e F... S....., për arkëtimin e detyrimit për **vlerën 883,200** lekë nga përfituesit (sipas listës nxjerrë nga Sektori i Auditit Brendshëm të Bashkisë Librazhd) dhe të nxirret përgjegjësia për moszbatimin e rekomandimeve.

Menjëherë

2/15.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd, nëpërmjet Drejtorisë së administrimit dhe mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave, të marrë masa për inventarizimit fizik, identifikimin e pasurive, plotësimin e hartave dhe rakordim me ZVRPP për sipërfaqet pyjore dhe kullimore në pronësi të saj, sipas kërkesave të VKM nr. 433, datë 8.6.2016”Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”.

Menjëherë

3.16.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Pyjor Elbasan, të ngrëjë grupe pune me specialistë për unifikimin e planit të mbarështimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve pyjore dhe kullotave, në gjithë njësitë administrative të saj.

Menjëherë

4/20.1.Rekomandimi: Bashkia Librazhd të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të pa realizuara të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, dhe të arkëtojë nga 53 personat dhe subjektet përgjegjës vlera **20,056,049** lekë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej.....38.778.004 lekë Deri më datën 30.09.2017 është arkëtuar vlera prej..... 4,553 748 lekë Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej..... 34,235, 246 lekë
Nga të cilat:

- Në proces arkëtimin 4 rekomandime në vlerën.....10,517,859 lekë
- Në proces gjyqësor 9 rekomandime në vlerën.....11,930,858 lekë
- Janë nisur njoftimet për 12 rekomandime por ende skanë filluar arkëtimet.....3,088,836 lekë
- Pagesa e këshilltarëve 1 rekomandim.....8,552,208 lekë
- Mos fillimi i ndalesave për tatimin mbi pagën e ish Këshilltarëve në vlerën ...145,485 lekë

Duke qenë se nga 23 masa për shpërblim dëmi në vlerën 38,778,004 lekë janë arkëtuar vlera prej 4,553,748 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar vlera 34,235, 246 lekë, nga e cila:

a-Për 9 rekomandime në proces gjyqësor në vlerën 11,930,858 lekë të vazhdojnë ankimimet në të gjitha shkallët e gjykimit.

b-Për 12 rekomandime në vlerën 3,088,836 lekë për të cilat janë nisur njoftimet por ende s’kanë filluar ndalesat, dhe për 4 rekomandimet në proces arkëtimin në vlerën 10,517,859 lekë, për të cilat në se nuk paraqiten personat për të paguar në mënyrë vullnetare ndaj tyre të hartohen paditë gjyqësore për shpërblim dëmi, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:**

1/2.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të nxjerrë aktin administrativ për ndalesën, të kontabilizojë dëmin ekonomik në shumën **526,000** lekë dhe të kërkojë në rrugë ligjore

arkëtimin e shumave respektivisht nga; **V. T.** ish-Kryetari i Komunës Polis në vlerën 30,000 lekë , **A. Xh.** ish-Kryetari i Komunës Lunik në vlerën 300,000 lekë dhe **A. F.** ish-Kryetari i Komunës Steblevë në vlerën 196,000 lekë.

Në vijimësi

2/4.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 63,000 lekë, nga 7 (shtatë) nëpunësit e ish-Komunës Lunik, për sa kanë përfituar padrejtësisht shpërblim për vitin 2014 (sipas aneksit nr.4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në vijimësi

3/5.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **115,200 lekë** për sa kanë përfituar shpërblime 16 nëpunës, të ish-Komunës Orenjë, sipas aneksit nr.3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në vijimësi

4/6.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **30,000 lekë** nga A. F. sa përfituar padrejtësisht bonus transporti.

Në vijimësi

5/7.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës tatimit mbi pagë për **291,865 lekë**, (në kundërshtim me ligjin nr.8438, datë 28.12.1998“Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 9) respektivisht nga: ZH. G vlera 4,000 lekë, V. M. vlera 2400 lekë, H. Sh. vlera 300 lekë, Xh. S. vlera 13,680 lekë,10 punonjës të administratës së ish-Komunës Hotolisht vlera 126,000 lekë, 22 ish-këshilltarët vlera 145,485 lekë (sipas aneksit nr.4,bashkëlidhur Raportit përfundimtar të Auditimit).

Në vijimësi

6/8.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **135,928 lekë**, nga Gj. P. sa përfituar më tepër në mbikëqyrjen e objektit “Ndërtim i shkollës 12-vjeçare Orenjë” dhe objektit “Ndërtim Ure tip bejl për fshatrat Gurakuq dhe Rinas”.

Në vijimësi

7/9.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **53,700 lekë** nga N L 26,850 lekë dhe F H 26,850 lekë.

Në vijimësi

8/10.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd, të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore, për arkëtimin nga ish-Kryetari i Komunës Orenjë N. L. të vlerës **20,000 lekë**.

Në vijimësi

9/11.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **60,000 lekë** nga F. A. detyrim për përfitimin e bonusit të transportit.

Në vijimësi

10/12.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **131,854 lekë** nga subjekti “D” për vlerën 13,553 lekë, subjekti “S. L.” në vlerën 15,400 lekë, “M.....” në vlerën 102,901 lekë.

Në vijimësi

11/13.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative për arkëtimin e **dëmit ekonomik** në vlerën **120,000 lekë**, nga likuidimi i plotë

i faturës nr.13 datë 02.12.2013, të operatorit ekonomik “R” për blerjen e vogël “Shërbim interneti” në ish-Komunën Hotolisht, përllëgaritur dhe paguar shërbimi për gjithë vitin 2013, kur ky shërbim sapo ishte kontraktuar në datë 02.12.2013, në kundërshtim me VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr.2 datë 28.03.2013, ndryshuar me Udhëzimin APP nr.5 datë 16.07.2013 dhe nr.1, datë 28.02.2014 (Trajtuar në faqet 41-93 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

Në vijimësi

12/14.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,079,990 lekë** respektivisht nga subjekti “H..” sh.p.k vlera 887,990 lekë dhe subjekti “F....” sh.p.k vlera 192,000 lekë.

Në vijimësi

13/15.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,278,570 lekë** nga ish titullari F. A. dhe komisioni i blerjeve me vlera të vogla G. A. L. Ç. dhe Xh. B. në vlerën 252,975 lekë secili si dhe komisioni i marrjes në dorëzim të punimeve/shërbimeve i përbërë nga A. P. Q. A. M. G. Sh. L. dhe E. Ç. në vlerën 53,333 lekë secili.

Në vijimësi

14/16.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **63,124 lekë**, nga subjekti S. Q.

Në vijimësi

15.17.1.Rekomandimi: Bashkia Librazhd të marrë masat administrative dhe të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **73,000 lekë**, nga KVO dhe titullari i autoritetit kontraktor ish-Komuna Orenjë, përkatësisht B. H. vlera 18,250 lekë, G. P. vlera 18,250 lekë, F. H. vlera 18,250 lekë, N. L. vlera 18,250 lekë, për s’kualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik ”P..... “ sh.p.k në procedurën e prokurimit “Blerje kamion për nevoja të ish-Ish-Komunës Orenjë”, viti 2014.

Në vijimësi

16/18.1. Rekomandimi: Bashkia Librazhd të marrë masat administrative dhe të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **439,430 lekë**, nga KVO dhe titullari i autoritetit kontraktor ish-Komuna Qendër Librazhd, përkatësisht E. C. vlera **109,857 lekë**, Sh. K. vlera **109,857 lekë**, I. Gj. vlera **109,857 lekë**, E. Sh. vlera **109,857 lekë** për s’kualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik ”E.....” sh.p.k, në procedurën e prokurimit ”Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Babje, Komuna Qendër Librazhd”, viti 2014.

Në vijimësi

17/19.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,788,329 lekë** pa tvsh nga OE “S.....” shpk, në cilësinë e hartuesit të projekt preventivit me objekt “Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave”, Bashkia Librazhd, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e rritjes fiktive të fondit limit.

Në vijimësi

18/20.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,207,500 lekë** pa tvsh nga OE “H....” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1211 prot., datë 25.08.2014 me objekt “Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave”, Bashkia Librazhd, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Në vijimësi

19/21.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,464,633 lekë** pa tvsh nga OE “S....” shpk, në cilësinë e hartuesit të projekt preventivit me

objekt “Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave Faza e II-të”, Bashkia Librazhd, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e rritjes fiktive të fondit limit.

Në vijimësi

20/22.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,713,697 lekë pa tvsh nga BOE “S.....” shpk dhe “B.....” shpk**, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 1321 prot., datë 31.03.2016, me objekt “Ndërtim, Sistemim, Asfaltim i Rrugës Kryesore të Fshatit Dragostunjë, Njësia Administrative Qendër”, Bashkia Librazhd, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Në vijimësi

21/23.1.Rekomandimi: Nga Zyra e taksave të Bashkisë Librazhd të merren masa për regjistrimin në kontabilitet si debitorë, krijimin e regjistrimit elektronik, të merren masa për arkëtimin dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore për 141 **Biznese dhe HEC-e në vlerën e pa arkëtuar deri më datën 17.11.2017 prej 10,943,267 lekë** (nga 13,878,022 lekë janë arkëtuar deri 17.11.2017 vlera prej 2,934,755 lekë) . (Lista me emrat janë pasqyruar në Përmbledhësen dhe Aneksit nga numri rendor 1 deri 11 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, (pavarësisht kërkesave të mëparshme duke i rikërkuar edhe njëherë për 145 bizneseve debitorë më datën 30.09.2016 në vlerën 11,818,426 lekë në Bashkinë Librazhd të cilat janë regjistruar në kontabilitet sipas Aneksit Nr.1. bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Për punonjësit të cilët marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës

-Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar ” dhe kontratën individuale të punës , nenit 64, shkronjat **g** dhe **k** të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Librazhd, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje**” deri në “**Zgjidhje të kontratës së punës** ” për 12 punonjës. Nga verifikimi rezultoi se janë dhënë 11 masa disiplinore “Vërejtje” duke mos u pranuar 1 masë disiplinore ”Vërejtje” për të cilën rikërkojmë dhënien e kësaj mase ndaj **E. S.** me detyrë ish Kryetar i Komunës Qendër Librazhd deri 30.06.2015 dhe aktualisht nën Kryetar i Bashkisë Librazhd.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D.1.Mbi gjobat e rekomanduara Agjencisë prokurimit Publik.

KLSH me shkresën nr 732/10 datë 26.12.2016 i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për **8 personat**. Nga verifikimi rezultoi se APP me vendimin nr. 42 datë 10.04.2017 duke vendosur masa dënim me gjobe për 3 persona dhe rekomandim për masë disiplinore për 7 persona (prej tyre vetëm 5 persona janë në marrëdhënie pune me Bashkinë Librazhd).

Bashkia Librazhd Drejtoria Juridike të marrë për ekzekutimin e 3 vendime të dënimit me gjobë sipas vendimit Agjencisë Prokurimit Publik nr. 42, datë 10.04.2017 në vlerën **300,000 lekë**, duke kërkuar në Gjykatë **për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv**, në zbatim të nenit 24 -Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **apo rivënien në afat** bazuar në nenet 151 dhe 152 të “Kodit Procedurës Civile në RSH”.

Menjëherë

TË TJERA

Gjatë verifikimit të zbatimit rekomandimeve në disa Bashki si Dibër, Librazhd, Devoll, Këlcyrë, përveç kësaj të fundit e cila nuk kishte filluar nga zbatimi i rekomandimeve për shpërblim dëmi, në Bashkitë e tjera për masat shpërblim dëmi ishin mjaftuar vetëm me dërgimin formal të njoftimeve, por me kërkesën e grupit të auditimit nga Drejtoritë Juridike të Bashkive respektive, u hartuan paditë gjyqësore për shpërblimin e dëmit, prandaj edhe mbi 65% e shpërblimit të dëmit është proces gjyqësor.

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces sipas rezultateve të këtij auditimi, kërkojmë dhe inkurajojmë përsheptimin e plan veprimit për realizimin e plotë të tyre brenda 20 ditëve nga marrja e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Pavarësisht auditimit që ne kemi kryer për zbatimin e rekomandimeve, ju kujtojmë që në mbështetje të nenit 30, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **jeni të detyruar që brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës**, duhet të raportoni me shkrim pranë KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve tona, si dhe ju bëjmë me dije se zbatimi i rekomandimeve do të jetë pjesë e auditimit të radhës nga KLSH, në subjektin Tuaj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

